ALPHA BANK

# ALPHA E - BANKING – ONLINE FORMULAR APLIKIMI PER INDIVIDE
# ALPHA E - BANKING - ONLINE APPLICATION FOR INDIVIDUALS

## TE DHENA PERSONALE/ PERSONAL INFORMATION

| | |
|---|---|
| Emer Mbiemer / Full Name : | |
| Nr Personal / Personal No: | |
| Date Lindja / Birth date: | |
| Nr. Telefoni / Phone Number: | |
| Adresa E-mail/ E-mail address: | |

## INFORMACION MBI LLOGARITE PERSONALE/ PERSONAL ACCOUNT INFORMATION

Unë dëshiroj të lidh llogaritë e mëposhtme me shërbimin Alpha e-Banking. [Zgjidh numrin i cili përfaqëson të drejtat e aksesit të cilat ju dëshironi të aplikoni, (1- Akses i Plotë, 2- Akses i Limituar)]

I wish to connect the following accounts to Alpha e-Banking. [Select the number which represents the access rights you wish to apply, (1- Full Access, 2 -Limited Access)]

Konfirmoj lidhjen e te gjitha llogarive, depozitave me afat dhe kredive, te mia te hapura me llogarine time Alpha e-Banking.

I confirm you to map all my active accounts, time depos, and loans to my Alpha e-Banking account.

Akses i Kërkuar / Required Access: 1

## TE DREJTAT E AKSESIT TE PERDORUESIT/USER ACCESS RIGHTS

Akses i Plotë/ 1 - Përdoruesi ka të drejtë të shohë llogaritë, kreditë, të kryejë transaksione. Konfirmon lidhjen e kartave të kreditit dhe pagesën e tyre. Për kryerjen e transaksioneve duhet të shkarkohet aplikacioni Alpha Safe Access dhe të bëhet lidhja e pajisjes software Token me llogarinë përkatëse e-Banking. / The user has the right to see accounts, loans and perform transactions. Confirms to add his credit cards and their payment. To conduct transactions will need the application Alpha Safe Access.

Akses i Limituar/ 2 - Përdoruesi ka të drejtë të shohë vetëm gjendjen apo transaksionet e bëra në llogaritë e tij. Përdoruesi nuk mund të kryejë transaksione. / The user has the right only to see the status or transactions made in his accounts. The user cannot perform transactions.

Unë konfirmoj saktësinë e detajeve të dhëna më sipër dhe se marr përsiper të njoftoj Bankën për çdo ndryshim të mëvonshëm të të dhënave të paraqitura. / I confirm the accuracy of the information presented here and accept to inform the bank for every change on this information.

Banka mund të përdori të dhënat tuaja personale të deklaruara nga ju (si psh numrin tuaj të telefonit, faksit apo adresën tuaj të e-mailit) për tju kontaktuar për qëllime marketingu duke përfshirë telemarketing. Ky nuk përbën kusht për bashkëpunim me ne dhe ju mund ta refuzoni në çdo kohë / The Bank can use the personal details declared by you (ex tel number, fax or e-mail address) to contact you for marketing purpose including telemarketing. This is not a condition cooperating with us and you may refuse it or rejected in any time.

**KONFIRMIM PER TE PROCEDUAR ME REGJISTRIMIN E TE DHENAVE TE MESIPERME NE SISTEM PAS DERGIMIT TE FORMES ME EMAIL.**
**CONFIRMATION TO PROCESS THE REGISTRATION OF THE ABOVE DATA IN THE SYSTEM AFTER SENDING THE FORM THROUGH EMAIL.**

Konfirmoj: PO

ALPHA BANK

**KUSHTET DHE AFATET E PËRDORIMIT PËR INDIVIDÊ**

**"Alpha E-Banking",** është shërbimi në distancë, nëpërmjet kanaleve elektronike të shpërndarjes dhe të komunikimit, të cilat sigurohen nga Banka, për Titullarin/bashkëtitullarin dhe/ose Përdoruesit të autorizuar, për të kryer veprimtari financiare dhe/ose bankare sipas shërbimeve të përcaktuara nga Banka.
**"Përdorues",** është çdo klient i bankës, i cili, në cilësinë e Titullarit/bashkëtitullarit dhe/ose Përdoruesit të autorizuar të llogarisë bankare dhe/ose depozitës dhe/ose kredisë, ka të drejtë të hyjë dhe të marrë shërbime përmes Alpha E-Banking.
**"Banka",** është Banka Alpha Albania SHA, degët, dhe përfaqësuesit e saj.
**"Ditë Pune",** është një ditë në të cilën Banka është e hapur për të kryer veprime, në përputhje me orarin zyrtar të punës të përcaktuar nga Banka.
**"Kushtet kontraktore",** janë tërësia e dispozitat kontraktore të përfshira në këtë dokument, të cilat rregullojnë marrëdhënien ndërmjet palëve sa i përket ofrimit të shërbimit Alpha E-Banking.
**"Udhëzimet e Përdorimit",** janë udhëzimet e nxjerra herë pas here nga Banka, të cilat rregullojnë mënyrën e kryerjes së operacioneve dhe përdorimin e shërbimit Alpha E-Banking dhe të cilat do i njoftohen Titullarit/bashkëtitullarit me anë të çdo mjeti/telefon, fax, e-mail, poste rekomande, që Banka e gjykon të përshtatshëm.
**"Pajisja Token",** është aplikacioni i dhënë Përdoruesit, i cili do të nxjerrë kodet (Njëpërdorimësh) të cilët do të përdoren sa herë Përdoruesi kryen një veprim Alpha E-Banking.
**"Fjalëkalimi",** është Numri Personal Unik i Identifikimit i dhënë nga Banka ose i krijuar nga Përdoruesi, i domosdoshëm për tu futur në shërbimin Alpha E-banking dhe lejon Përdoruesin të kryejë veprime përmes këtij shërbimi.
**"Numri i Klientit",** është numri i identifikimit i lëshuar nga Banka për çdo Përdorues, i cili së bashku me fjalëkalimin, do të shërbejë për hyrjen në shërbimin Alpha E-Banking duke i mundësuar kryerjen e veprimeve përmes këtij shërbimi "Palët e treta" janë klientët e Bankës Alpha Albania, të ndryshëm nga Përdoruesit, Banka të tjera lokale dhe çdo person fizik apo juridik.
**"Urdhërat fiks",** janë pagesa periodike të cilat urdhërohen nga klienti të kryhen me një frekuencë dhe periudhë kohe të caktuar.
**"Identifikimi Biometrik",** është verifikimi i identitetit të klientit, duke përdorur një veçori fizike të tij, siç është shenja e gisht ose njohja e fytyrës. Identifikimi duke përdorur këtë metodë është absolutisht në zgjedhje të klientit.

**Seksioni I – Veçoritë e shërbimit Alpha E-Banking**

**1. Objekti i kontratës**
Objekti i kësaj kontrate është:
1.1 Rregullimi i marrëdhënies ndërmjet palëve sa i përket ofrimit të shërbimeve të përmendura në këtë Kontratë, të tilla që i japin Titullarit/Bashkëtitullarit të llogarisë dhe/ose Përdoruesit të drejtën për të marrë informacion dhe të kryer transaksione, duke përdorur shërbimin Alpha E-banking.

**2. Aktivizimi dhe Hyrja në Shërbimin "Alpha E-Banking"**
2.1 Shërbimi Alpha E-banking u ofrohet Titullarëve/bashkëtitullarëve të llogarisë dhe/ose Përdoruesve të autorizuar, të cilët, paraprakisht janë njohur dhe kanë pranuar kushtet dhe afatet kontraktore të përdorimit të shërbimit "Alpha E-banking" për individë, si dhe janë pajisur nga Banka me kodet përkatëse të aktivizimit të shërbimit.
2.2 Titullari/Bashkëtitullari dhe/ose Përdoruesi do të përdorë Numrin e Klientit dhe Fjalëkalimin në mënyrë që të ketë të drejtën e hyrjes në shërbimin Alpha E-Banking.
2.3 Urdhërat e dhëna Bankës me anë të aplikimit dhe/ose ndonjë urdhër i ardhshëm i lidhur me veprime në Llogari përmes Alpha E-Banking, do të zbatohen vetëm për veprimet që përfshihen në shërbimin Alpha E- Banking.
2.4 Banka ka të drejtën që në mënyrë të njëanshme të miratojë, ose të refuzojë aplikimin për regjistrim në shërbimin Alpha E-Banking, si dhe të bëjë modifikime që mund t'i konsiderojë të përshtatshme.

**3. Pajisja e Përdoruesit me kodet për hyrjen në shërbim**
3.1 Banka informon Përdoruesin mbi shërbimin E-banking dhe kanalet e përdorimit si: adresa në internet (web-site), aplikacionet mobile "Alpha E-banking" dhe "Pajisja Token" dhe e informon atë për mënyrën e marrjes së "Numrit të klientit" dhe "Fjalëkalimit".
3.2 Numri i klientit dhe Fjalëkalimi krijohen për klientin pas nënshkrimit të kësaj kontrate.
3.3 Numri i Klientit dhe Fjalëkalimi do t'i dërgohen elektronikisht në adresën e-mail dhe me "SMS" (Short Message Service) në numrin e tij të telefonit sipas përcaktimeve të bëra prej Përdoruesit në formularin e aplikimit.
3.4 Vendosja e gabuar e Fjalëkalimit për tre përpjekje të njëpasnjëshme, sjell pamundësinë e hyrjes në Shërbim dhe bllokimin e përdorimit të tij. Me kërkesë të Përdoruesit, për qëllime të hyrjes sërish në sistem, Banka zhbllokon llogarinë dhe/ose aktivizon një Fjalëkalim të ri dhe ia njofton Përdoruesit në përputhje me parashikimet e nenit 3.3. Për arsye sigurie, Përdoruesi është i detyruar të ndryshojë Fjalëkalimin.
3.5 Identifikimi Biometrik. Përdoruesi mund të zgjedhë përdorimin e identifikimit biometrik dhe mund të zgjedhë identifikimin me shenjë gishti ose njohjen e fytyrës për të bërë hyrjen në aplikacionin Alpha E-banking. Shenja e gishtit dhe njohja e fytyrës bazohen në teknologjinë e pajisjes që zotëron klienti, dhe Banka Alpha nuk ka të drejtë dhe nuk mund të kontrollojë të dhënat biometrike të ruajtura në pajisjen e Përdoruesit.
Identifikimi i Përdoruesit të Alpha E-banking do të bëhet në përputhje me një nga llojet e identifikimit (Shenjë gishti apo Njohja e Fytyrës)
3.6 Përdoruesi është përgjegjës për çdo pasojë të dëmshme që mund të rrjedhë nga abuzimi ose keqpërdorimi i kodeve të identifikimit ose dërgimi i fjalëkalimit tek palë të treta.

4 **Detyrimet e Bankës**

4.1 Banka ka detyrimin:

4.1.1 Të sigurojë që kodet e identifikimit për të hyrë në shërbimin "Alpha E-Banking" të mos jenë të akseksueshme për subjekte të ndryshme nga Përdoruesi;

4.1.2 Të sigurojë gjithmonë disponueshmërinë e numrit telefonik të kontaktit, në mënyrë që Përdoruesi të mund të kryejë komunikimin me Bankën për të njoftuar veprime të parashikuara në nenin 6 të këtij Seksioni**;**

4.1.3 T'i sigurojë Përdoruesit që komunikimin me Bankën për të njoftuar veprime të parashikuara në nenin 6 të këtij Seksioni ta kryjë pa pagesë;

4.1.4 Të parandalojë çdo përdorim të shërbimit pas njoftimit të Përdoruesit për veprime të parashikuara në nenin 6 të këtij Seksioni.

**5. Detyrimet e Përdoruesit**

5.1 Përdoruesi ka detyrimin:

5.1.1 Të përdorë shërbimin duke treguar një kujdes të zakonshëm dhe në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë kontratë. Sapo të marrë në dorëzim kodet e identifikimit për të hyrë në shërbim, ai duhet të marrë të gjitha masat e arsyeshme të përshtatshme për t'i mbrojtur ato dhe siguroni konfidencialitetin e tyre.

5.1.2 Të ruajë kodet e identifikimit të hyrjes në shërbim me kujdes të veçantë, duke u siguruar që ato të mos ruhen së bashku ose të mbahen të evidentuara në një vend të vetëm. Këto kode identifikimi janë për përdorim ekskluziv të Përdoruesit dhe nuk mund t'i dorëzohen apo njoftohen subjekteve tretë.

**6. Humbja, vjedhja, përvetësimi me të padrejtë ose përdorimi i paautorizuar i kodeve të identifikimit**

6.1. Në rast të humbjes, vjedhjes, përvetësimit të padrejtë ose përdorimit të paautorizuar të kodeve të identifikimit, Përdoruesi detyrohet të informojë Bankën menjëherë dhe pa asnjë vonesë, sapo ai të kuptojë apo të marrë dijeni për ndonjë prej rasteve të sipërcituara, elektronikisht përmes shërbimit Alpha E-Banking, duke marrë në telefon në numrin +355 4 22 78 736 (brenda orarit zyrtar të bankës) ose duke u paraqitur në degën më të afërt të bankës. Për arsye sigurie dhe transparence, çdo thirrje telefonike drejt këtyre numrave do të rregjistrohet.

6.2. Njoftimi i Bankës për ngjarjen sipas nenit 6.1, sjell si pasojë bllokimin e kodeve të identifikimit të kompromentuar dhe pamundësinë për të përdorur shërbimin Alpha E-Banking. Me kërkesë të Përdoruesit, për qëllime të hyrjes sërish në sistem, Banka aktivizon një Numër të ri fillestar Personal të Identifikimit dhe i'a njofton Përdoruesit në përputhje me parashikimet e nenit 3.3.

6.3. Banka do të bllokojë përdorimin e shërbimit për Përdoruesin pa asnjë asnjë kosto shtesë, sapo të marrë njoftim për ngjarjen sipas nenit 6.1.

6.4. Përdoruesi detyrohet të bashkëpunojë plotësisht me Bankën, duke ofruar çdo informacion në nevojshëm në lidhje me sqarimin e rrethanave në të cilat kodet e identifikimit rezultuan të humbura, vjedhura, përvetësuara me të padrejtë ose të përdorura në mënyrë të paautorizuar.

**7. Detyrimet e Përdoruesit për administrimin e Numrit të Klientit /Fjalëkalimit/Pajisja Token**

7.1. Përdoruesi (ose përfaqësuesi i tij i autorizuar) është përgjegjës për humbjen e çdo shume në monedhë vendase apo të huaj, në rast humbje, vjedhje apo keqpërdorimi të Numrit të Klientit, Fjalëkalimit dhePajisjes Token deri në momentin kur Banka merr njoftimin rreth ngjarjes.

7.2. Përdoruesi është përgjegjës nëse, në sajë të neglizhencës së tij të plotë, ai nuk përmbush detyrimet e tij, të cilat janë përmendur në pikën 7.3 si më poshtë, ose vepron në mënyrë të pandershme me qëllim për të përfituar shuma nga Banka.

7.3. Përdoruesi duhet:

a) Të përdorë kodet e përdorimit dhe pajisjen Token, sipas kushteve dhe afateve të publikuara për përdorim dhe në mënyrë më specifike, të marrë masat e nevojshme për të ruajtur këto kode, të cilat mundësojnë përdorimin e shërbimit Alpha E-Banking.

b) Të informojë Bankën menjëherë sipas kushteve të paragrafeve 5.3.

c) Të mos i regjistrojë kodet e përdorimit në një mënyrë lehtësisht të kuptueshme.

**8. Ofrimi i Shërbimit**

8.1 Banka siguron funksionimin e rregullt të shërbimeve të Alpha E-banking, me përjashtim të rasteve kur shfaqen probleme të cilat janë jashtë kontrollit të Bankës, si shkëputja e linjës së internetit, përditësimi i sistemit operativ të Bankës apo mirëmbajtja e programuar e sistemit nga ana e ofruesit të shërbimit Alpha E-banking.

8.2 Është e përjashtuar çdo përgjegjësi e Bankës për ndërprerje, pezullime, funksionim të parregullt ose të dështuar të shërbimeve të ofruara nga Alpha E-Banking për arsye që nuk varen nga vullneti i Bankës. Në rast të mosfunksionimit të shërbimit, keqfunksionimit të rrjetit të Internetit, pasaktësi, paplotësi ose mungesë efektshmërie e sistemit, Përdoruesi është i detyruar të mos kryejë operacione të mëtejshme.

8.3 Përdoruesi është i detyruar të ndjekë me përpikmëri procedurat e funksionimit të shërbimit Alpha E-Banking, të cilat janë të ilustruara dhe të azhornuara vazhdimisht në faqen e internetit të shërbimit, duke përdorur rregullisht zonën e tij të rezervuar të faqes së internetit dhe, në veçanti, faqet e internetit që ofrojnë informacion të vazhdueshëm rreth mënyrave të komunikimit që do të përdoren në kontekstin e shërbimit si dhe mbi risitë tekniko-organizative të zhvilluara prej Bankës për të ruajtur vazhdimisht një nivel adekuat të sigurisë në ofrimin e shërbimit.

8.4 Përdoruesi autorizon Bankën të mos kryejë asnjë operacion:

- I cili është kërkuar të kryhet në një mënyrë, tërësisht ose pjesërisht, të ndryshme nga ato të treguara në kontratë;
- Të cilin sistemi e bllokon për arsye sigurie dhe për të cilin kërkohet konfirmim specifik nga ana e Përdoruesit të njoftuar prej Bankës sipas mënyrave të njoftimit alternativ.

8.5 Përdoruesi autorizon në mënyrë të shprehur Bankën të krijojë dhe mirëmbajë sisteme për regjistrim të vazhdueshëm dhe automatik të transaksioneve, komunikimeve dhe bisedave telefonike (pavarësisht protokolleve të përdorura për transmetimin e të dhënave) dhe/ose në Internet si pasojë e përdorimit të shërbimeve Alpha E-Banking.

8.6 Palët pranojnë reciprokisht që, duke marrë parasysh natyrën e shërbimeve të Alpha E-Banking, për qëllime të provueshmërisë së operacioneve të kryera, si dhe të komunikimeve të bëra, do të konsiderohen të vlefshme regjistrat kontabël të Bankës, regjistrimet e kryera në përputhje me pikën e mësipërme 8.5 si dhe, më në përgjithësi, të gjithë regjistrimet dixhitale të të dhënave të shkëmbyera prej palëve, të mirëmbajtuara prej vetë Bankës.

**9. Pezullimi i ofrimit të shërbimi**

9.1 Banka mund të bllokojë përdorimin e shërbimit - dhe eventualisht edhe operacionet që janë nën proces ekzekutimi - për arsye të justifikuara të lidhura me një ose më shumë prej elementëve të mëposhtëm:
- Çështje që prekin drejtëpërdrejtë apo tërthorazi sigurinë e ofrimit të shërbimit;
- Dyshimi për përdorim mashtrues ose të paautorizuar të kodeve të identifikimit (përfshirë, rastet kur rezulton që operacioni i kërkuar të tejkalojë tepricën kreditore të disponueshme);

9.2 Në rastet e përmendura në paragrafin e mëparshëm 9.1, Banka informon Titullarin/Bashkëtitullarin e Llogarisë dhe/ose Përdoruesin për bllokimin e shërbimit, duke dhënë arsye për këtë vendim. Kur është e mundur, njoftimi për bllokimin e shërbimit jepet paraprakisht, ose menjëherë pas marrjes së vendimit nga ana e Bankës për të bllokuar ofrimin e shërbimit, përveç rastit kur dhënia e këtij njoftim përbën cënim të sigurisë ose vjen në kundërshtim me kuadrin ligjor apo rregullator në fuqi.

9.3 Kur shkaqet e bllokimit të shërbimit shuhen, Banka e riaktivizon menjëherë ofrimin e shërbimit.

**10. Zgjidhja e kontratës**

10.1 Banka ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë, duke njoftuar paraprakisht me shkrim në adresën e regjistruar në sistemet e Bankës, me “SMS” në numrin e telefonit, ose në adresën elektronike Përdoruesin 30 (tridhjetë) ditë përpara ditës së përcaktuar për përfundimin e raportit kontraktor, ose dhe pa njoftim paraprak kur ka shkaqe të arsyeshme për zgjidhjen e kontratës. Titullari/Bashketitullari i llogarisë dhe/ose përdoruesi ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë në çdo kohë, duke patur detyrimin që të mbyllë menjëherë llogarinë e tij në Alpha E-banking.

10.2 Në rastet kur Titullari/Bashketitullari i llogarisë dhe/ose përdoruesi ka ndërruar jetë apo ka humbur zotësinë juridike për të vepruar, trashëgimtarët e tij apo përfaqësuesi i tij ligjor janë të detyruar të kërkojnë mbylljen e shërbimit Alpha E-banking. Titullari/Bashketitullari i llogarisë dhe/ose përdoruesi, i cili sipas përcaktimeve të këtij neni ka detyrimin për të mbyllur shërbimin Alpha E-banking dhe nuk ka e përmbushur këtë detyrim, vazhdon të jetë përgjegjës për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga përdorimi i kartës apo nga çdo lloj detyrimi tjetër i lindur mbi bazën e kësaj kontrate.

## Seksioni II – Transaksionet nëpërmjet shërbimit Alpha E-Banking

**1. Fusha e veprimit dhe veçoritë e shërbimit të pagesave Alpha E-Banking**

1.1 Ky Seksion zbatohet për shërbimet e pagesave të ofruara në Shqipëri dhe më tej në gjithë vendet e tjera të botës në përputhje me dispozitat e vendit ku do të kryhet pagesa të përdorur për ofrimin e shërbimit.

1.2 Ky Seksion rregullon në përgjithësi të gjitha shërbimet e mëposhtme të pagesave që Banka ofron përmes shërbimit Alpha E-Banking (në varësi të natyrës së marrëdhënieve bankare të lidhura me shërbimin Alpha E-Banking. Shërbimet e mëposhtme të pagesave mund të ofrohen vetëm pjesërisht apo dhe të mos të jenë disponueshme për t’u ofruar: në këto raste ky Seksion do të jetë pjesërisht i zbatueshëm ose nuk do të jetë aspak i zbatueshëm):

a) Transfertë drejt një banke tjetër /Transfert Sepa (SCT Sepa Credit Transfert): veprim pagese (kombëtar ose ndërkufitar) i kryer nga banka, në emër të Përdoruesit, me qëllim të vënies në dispozicion të një Përfituesi një shume parash të numërueshme, pa kufizuar mundësinë që Përdoruesi të jetë i njëjtë me Përfituesin e pagesës;
b) Transferta parash brenda bankës: veprim pagese që i mundëson Përdoruesit të transferojë dhe të marrë fonde në dhe nga llogaritë rrjedhëse dhe/ose Instrumentat e pagesës elektronike përmes sistemeve të pagesave me pakicë tek të cilat Banka mbështetet;
c) Pagesa utilitare;

**2. Urdhri për kryerjen e pagesës**

2.1 Për çdo kërkesë për kryerje veprimi të porositur prej Përdoruesit, urdhri i pagesës i jepet bankës prej këtij të fundit. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Përdoruesi, autorizon Bankën të ekzekutojë çdo urdhër të dhënë nga Përdoruesi përmes shërbimit Alpha E-Banking.

2.2 Urdhri i pagesës duhet të tregojë, kur kërkohet, të dhënat e sakta identifikuese të palës pëfituese, në përputhje me sa shpjegohet më poshtë si shembull:
- Për transfertë drejt një banke tjetër /Transfert Sepa (SCT Sepa Credit Transfert) Përdoruesi duhet të përcaktojë në urdhrin e pagesës IBAN-in;
- Për transferta parash brenda Bankës, Përdoruesi duhet të përcaktojë në urdhrin e pagesës numrin e llogarisë së Përfituesit ;
- Për pagesa të faturave, Përdoruesi duhet të përcaktojë në urdhrin e pagesës numrin e faturës dhe entin përfitues;

- Për pagesa për kartën e kreditit duhet të përzgjedhë kartën në të cilën do të kryejë pagesën, etj

**3. Marrja e urdhrit të pagesës**

3.1 Koha e marrjes së urdhrit të pagesës do të konsiderohet momenti kur urdhri mbërrin në bankë. Përpara kohës së marrjes së urdhrit prej Bankës, llogaria rrjedhëse e klientit nuk mund të debitohet. Nëse koha e marrjes nuk përkon me ditën e punës, urdhri i pagesës konsiderohet se është marrë nga Banka në ditën pasardhëse të punës.

3.2 Në rastin kur kërkesa përcakton që ekzekutimi i urdhrit të pagesës të kryhet në një ditë tjetër të mëvonshme se ajo e marrjes së urdhrit ose të kryhet në fund të një periudhe të caktuar ose të kryhet me kusht që Përdoruesi të ketë derdhur fondet e nevojshme në llogarinë bankare, koha e marrjes të urdhrit do të përkojë me ditën e përcaktuar prej Përdoruesit. Nëse dita e përmendur nuk bie në ditë pune, urdhri konsiderohet i marrë ditën pasardhëse të punës.

**4. Refuzim i urdhrit të pagesës**

4.1 Kur urdhri i pagesës është dhënë në përputhje me të gjithë kushtet e kësaj kontrate, Banka detyrohet ta konsiderojë atë si të autorizuar nga Përdoruesi dhe nuk mund të refuzojë ta ekzekutojë, përveç rasteve kur ekzekutimi vjen në kundërshtim me dispozita të kuadrit rregullator dhe ligjor.

4.2 Nëse Banka refuzon të ekzekutojë një urdhër pagese, shkaqet e refuzimit, si dhe procedura që Përdoruesi duhet të ndjekë për të korrigjuar gabimet e kryera prej tij dhe që kanë shkaktuar refuzimin, i komunikohen Përdoruesit me anë të një prej formave të komunikimit në distancë (telefonatë ose sms), përveç rasteve kur konsiderohet se dhënia e këtij informacioni përbën shkelje të dispozitave të kuadrit rregullator dhe ligjor, për shembull kur të dhënat e pagesës nuk janë të sakta.

4.3 Përdoruesi detyrohet të mbajë në llogari fonde të mjaftueshme për të ushtruar të drejtën e tij të disponimit të tyre, në të kundërt nuk mund të pretendojë që Banka të ekzekutojë urdhrin e tij në mungesë së këtyre fondeve. Për këtë arsye, nuk do të konsiderohet refuzim i urdhrit të pagesës prej bankës në rast se Përdoruesi nuk ka gjendje të mjaftueshme fondesh në llogari.

4.4 Një urdhër pagese që nuk është ekzekutuar për arsye objektive të justifikuara, (për shembull nëse të dhënat e pagesës nuk janë të sakta, ose nëse klienti nuk ka ndjekur hapat e duhur për përfundimin e pagesës), konsiderohet se nuk është marrë ndonjëherë prej Bankës. Për këtë arsye, pagesa e kërkuar mund të kryhet vetëm nëse Përdoruesi jep një urdhër të ri pagese, i cili të jetë në përputhje me të gjitha kushtet e nevojshme për ekzekutimin e tij të saktë.

**5. Autorizim i kryerjes së pagesës, dhënia e pëlqimit dhe revokimi**

5.1 Për qëllime të ekzekutimit të urdhrave të pagesës të dhënë prej Përdoruesit, palët pranojnë se përdorimi i kodeve të identifikimit dhe të kodit OTP (atje ku janë të aplikueshme) prej Përdoruesit, do të ketë të njëjtin efekt sikur urdhri të ishte nënshkruar prej këtij të fundit në prezencë të përfaqësuesve të Bankës dhe kjo do të përbëjë dhënien e pëlqimit prej Përdoruesit për ekzekutimin e Urdhrit.

5.2 Pëlqimi për të kryer një transaksion pagese ose një seri transaksionesh pagese mund të revokohet në të njëjtën mënyrë me të cilën është dhënë urdhri dhe revokimi lejohet deri në kohën kur urdhri bëhet i pakthyeshëm, sikurse përcaktohet në pikën 6 më poshtë. Revokimi i dhënies së pëlqimit në lidhje me ekzekutimin e një sërë operacionesh parandalon ekzekutimin e operacioneve vijuese të cilat, nëse ekzekutohen, ato konsiderohen të paautorizuara.

**6. Pakthyeshmëria e urdhrit të pagesës (pamundësia për të revokuar autorizimin**

6.1 Si rregull, urdhri për pagesë i dhënë drejtëpërdrejtë prej Përdoruesit sipas kushteve të kësaj kontrata konsiderohet i pakthyeshëm.

6.2 Në rastin e urdhrave të pagesave për të cilat Përdoruesi ka përcaktuar që ekzekutimi të kryhet në një ditë të caktuar të ndryshme nga koha e marrjes së urdhrit ose në fund të një periudhe të caktuar ose në ditën kur Përdoruesi do të ketë fonde të mjaftueshme në llogari, revokimi i urdhrit lejohet jo më vonë se fundi i ditës së punës përpara ditës së dakorduar për të ekzekutuar urdhrin.

**7. Regjistrimi i veprimeve dhe kërkesa për informacion**

7.1 Transaksionet e pagesave të kryera regjistrohen në ekstraktin e llogarisë rrjedhëse të përdorur si "llogari pagese", e rregulluar me dispozitat e kontratës së llogarisë rrjedhëse të nënshkruar nga Përdoruesi në cilësinë e Mbajtësit të llogarisë.

7.2 Përpara ekzekutimit të një urdhri pagese, Përdoruesi ka të drejtë të kërkojë informacion të qartë dhe të hollësishëm nga banka për kohën maksimale të ekzekutimit dhe tarifat e shërbimit nëse janë të aplikueshme. Banka i vë në dispozicion këto informacione përmes fletës së informacionit.

7.3 Në çdo kohë të marrëdhënies, Përdoruesi mund të kërkojë kopje të kësaj kontrate në një nga degët e Bankës.

**8. Përgjegjësia e Bankës për ekzekutimin e pagesave të paautorizuara**

8.1 Në rast se një transaksion pagese nuk është autorizuar, Banka detyrohet të rimbursojë menjëherë dhe pa humbur kohë Përdoruesin për shumën e të njëjtit transaksion.

8.2 Nëse llogaria rrjedhëse e Përdoruesit është debituar për ekzekutimin e urdhrit të paautorizuar të pagesës, Banka rikthen llogarinë në gjendjen në të cilën do të kishte qenë nëse ekzekutimi i pagesës nuk do të kishte ndodhur.

8.3 Në rast të një dyshimi të arsyeshëm për mashtrim, Banka mund të pezullojë rimbursimin e përmendur në paragrafin e parë, duke i dhënë komunikim të menjëhershëm me shkrim Bankës së Shqipërisë dhe Përdoruesit brënda 30 ditëve nga data e kryerjes së rimbursimit sipas kushteve në Seksionin 2, Neni 13, pika 13.1.

8.4 Pavarësisht rimbursimit të shumës, në rast se Banka, qoftë edhe në një kohë të vonë, provon se urdhri për kryerjen e pagesës ishte i autorizuar, kjo e fundit ka të drejtë të debitojë drejtpërdrejtë llogarinë e Përdoruesit për shumën e rimbursuar padrejtësisht në favor të tij.

**9. Afatet e ekzekutimit të urdhrit të pagesës**

9.1 Banka do të ekzekutojë çdo urdhër të marrë përmes shërbimit Alpha E-Banking sa më shpejtë të jetë praktikisht e mundur. Banka, përveç rasteve të pezullimit të shërbimit të Alpha E-Banking sipas paragrafit 16, do të ekzekutojë urdhrat, duke respektuar rendin kohor si më poshtë:

**a)** Urdhër transfertat në llogari (të vetë Titullarit të llogarisë, ose të ndonjë pale të tretë) e mbajtur me Bankën, ose me ndonjë bankë tjetër lokale, do të proçesohen deri në fund të ditës tjetër të punës.

**b)** Udhëzimet për Urdhër Pagesën (përveç atyre të përmendura më lart në Seksionin II, Neni 9, pika (a)), nëse Titullari/Bashkëtitullari i llogarisë është i përshtatshëm për të kryer të tilla transaksione, do të proçesohen brenda 2(dy) ditëve pune.

**c)** Urdhërat për kryerjen e pagesave të faturave do të ekzekutohen deri në fund të ditës tjetër të punës.

9.2 Moskryerja nga Banka për ndonjë arsye, ose tjetër për të arritur hapat kohorë të mësipërm nuk do t'i shkaktojë ndonjë detyrim Përdoruesit. Banka do të ketë të drejtën të ndryshojë hapat e mësipërm duke e njoftuar me shkrim Titullarin/Bashkëtitullarin e llogarisë. Për transaksionet në pikën 12.1 më sipër, Banka nuk do të mbajë përgjegjësi, në qoftë se Banka përfituese ose vetë përfituesi nuk e pranojnë veprimin.

**10. Kufijtë mbi shumat e veprimeve**

10.1. Banka ka të drejtën të kufizojë frekuencën dhe vlerën maksimale të lejuar për pagesa për arsye sigurie. Kufijtë maksimal mund të variojnë dhe ndryshojnë sipas vullnetit të Bankës dhe manualit te brendshëm te saj. Titullari/Bashkëtitullari i llogarisë dhe Përdoruesi mund të informohen rreth kufijve të veprimeve të tyre përmes shërbimit Alpha E-Banking.

**11. Ekzekutimi i Urdhërave Fiks**

11.1. Duke parashtruar udhëzimet për Urdhërat Fiks përmes shërbimit Alpha E-Banking, Titullari/Bashkëtitullari i llogarisë autorizon Bankën të kryejë pagesa periodike dhe të debitojë llogarinë e saj/tij me shumën ekuivalente, plus ndonjë tarifë që mund të aplikohet per shërbimin e kryer.

11.2. Gjithashtu, Titullari/Bashkëtitullari i llogarisë deklaron dhe pranon se Banka:

a. Nuk merr përsipër të këshillojë Titullarin/Bashkëtitullarin e Llogarisë për mospagesat në datën e caktuar si pasojë e pamjaftueshmërisë së fondeve në llogarinë e tij/saj për çdo arsye dhe ka të drejtë të këshillojë, nëse kjo kërkohet.
b. Nuk merr përsipër të ndikojë në ndonjë pagesë pas datës së caktuar, e cila nuk është kryer si pasojë e pamjaftueshmërisë së fondeve në llogarinë e tij/saj për çdo lloj arsye.
c. Ka të drejtë të anullojë Urdhërat Fiks në qoftë se në tre raste pasuese nuk mund të kryhet pagesa, si pasojë e pamjaftueshmërisë së fondeve në llogarinë e Titullarit/Bashkëtitullarit të Llogarisë.

**12. Transaksione në Monedhë të Huaj**

12.1 Në rast të urdhrave për pagesa të menjëhershme në monedhë të huaj, kursi i këmbimit që do të përdoret për transaksionet do të jetë kursi ekzistues në datën e ekzekutimit. Ky kursështëi publikuar në Alpha E-banking dhe mund të kontrollohet në çdo moment nga Përdoruesi.

12.2 Të gjitha transfertat në monedhë të huaj janë subjekt i rregullave të Bankës së Shqipërisë.

12.3 Një komision do të ngarkohet mbi shumën e transaksionit në lidhje me praktikën që ndjek Banka për komisionet.

**13. Disponueshmëria, Ndryshimet dhe Përfundimi i Shërbimit**

13.1 Banka ka të drejtë të ndryshojë në mënyrë të njëanshme kushtet e kësaj kontrate, por vetëm për arsye të rëndësishme. Banka, në rast se ndryshon kushtet dhe afatet e kësaj kontrate, detyrohet të njoftojë individualisht me shkrim Titullarin/Bashkëtitullarin e llogarisë dhe/ose Përdoruesin nëpërmjet dërgimit me postë rekomande në adresën më të fundit të njohur nga banka ose në adresën elektronike që Titullari/Bashkëtitullari i llogarisë dhe/ose Përdoruesi i ka njoftuar bankës me shkrim sipas kushteve të përgjithshme të punës së bankës me klientët ose me mesazh telefonik, duke mbajtur të dokumentuar këtë njoftim, 30 (tridhjetë) ditë pune përpara se ndryshimet të hyjnë në fuqi. Gjithashtu, banka ka detyrimin për të njoftuar këto ndryshime nëpërmjet afishimit të njoftimeve ose broshurave në ambientet e bankës, në faqen zyrtare të internetit ose me mjetet e komunikimit masiv. Titullari/Bashkëtitullari i llogarisë dhe/ose Përdoruesi ka të drejtë që, kur nuk është dakord me ndryshimet e sipërcituara të kushteve dhe afateve të kontratës, të njoftojë zgjidhjen e kontratës brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga dita e marrjes së njoftimit përkatëse, kohë e cila konsiderohet nga palët kontraktuese si kohë e arsyeshme

**13.1.1** Njoftimi do të konsiderohet i kryer me dërgimin e tij me një nga mënyrat e përcaktuara më lart, edhe në rast se Titullari/Bashkëtitullari i llogarisë dhe/ose Përdoruesi ka ndryshuar ndonjë nga mënyrat e kontaktit dhe nuk ka njoftuar Bankën për këtë ndryshim.

**13.1.2** Në qoftë se Titullari/Bashkëtitullari i llogarisë dhe/ose Përdoruesi nuk njofton zgjidhjen e kontratës brenda periudhës kohore të lart përmendur, vijimi i përdorimit të shërbimit konsiderohet si pranim i këtyre ndryshimeve.

14. **Proçedurat për zgjidhjen e ankimeve dhe mosmarrëveshjeve**.

14.1 Në rast se Përdoruesi ka pakënaqësi nga ofrimi i sherbimit detyrohet që të njoftojë sa më shpejt Bankën, duke paraqitur zyrtarisht ankesë/kërkesë në një nga format e mëposhtme:

- Personalisht: Klienti mund të paraqesë ankesë / kërkesë në çdo Degë të Bankës duke plotësuar formularin përkatës;
- Nëpërmjet telefonit: Duke i telefonuar "Qendrës Telefonike për Mbështetjen e Klientëve" në numrin e telefonit +355697028700
- Me Postë: Letrat i drejtohen Bankës nëpërmjet Postës
- Mesazh në faqen zyrtare të internetit të Bankës: http://www.alphabank.al;
- Nëpërmjet E-mail në adresën ebanking.albania@alpha.gr

14.2 Në rast se Përdoruesi dhe Banka kanë përdorur çdo mënyrë për të zgjidhur konfliktin ndërmjet tyre dhe kjo nuk ka sjellë asnjë rezultat, atëherë Banka dhe Përdoruesi mund t'i dërgojnë një letër Bankës së Shqipërisë duke paraqitur të gjitha të dhënat dhe detajet e rastit të veçantë.

**15. Komisionet dhe tarifat**

15.1 Tarifat, shpenzimet, dhe komisionet e tjera si pasojë e kryerjes së transaksioneve nëpërmjet Alpha E-banking do të përballohen nga Titullari/Bashkëtitullari dhe/ose Përdoruesi me shumat që çdo herë përcaktohen sipas kushteve të punës së Bankës për klientët që publikohen në mjediset e Bankës, të cilat debitohen automatikisht në llogarinë kryesore.

15.2 Banka mund të ndryshojë këto komisione, tarifa të aplikueshme dhe njofton klientin sipas kushteve në Seksionin 2, Neni 13, pika 13.1 nëpërmjet publikimeve në ambientet e degëve të Bankes, me shkrim në adresën e fundit, me "SMS" në numrin e telefonit, ose në adresën elektronike të Titullarit/Bashkëtitullarit dhe/ose Përdoruesit të regjistuar në sistemet e Bankës.

**16. Konfidencialiteti**

16.1 Titullari i llogarisë deklaron se është i informuar dhe i jep pëlqimin bankës për të mbajtur e përpunuar plotësisht të gjitha të dhënat e tij personale që i janë vënë në dispozicion bankës në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me ligjin e përmendur në pikën 16.4.

16.2 Banka ruan konfidencialitetin dhe/ose sekretin për të gjithë informacionin personal të titullarit të llogarisë duke i garantuar ruajtjen dhe administrimin e informacionit personal në sisteme të sigurta dhe të besueshme informacioni apo pagesash.

16.3 Kërkesat e këtij neni nuk zbatohen në rastet kur Banka detyrohet ta japë informacionin personal sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

16.4 Administrimi dhe mbrojtja e të dhënave personale bëhet në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 dhe Ligj Nr.120/14, datë 18/09/2014, Aktet Rregullatore përkatese të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

**17. Kushte të tjera të karakterit të përgjithshëm**

17.1 Pavarësisht ndarjes nga jeta ose paaftësisë së Përdoruesit, Banka do të ekzekutojë të gjithë urdhërat e dhënë përmes përdorimit të Numrit të Klientit, fjalëkalimit dhe të një kodi OTP (atje ku përdoret), deri në momentin që Banka do të marrë një njoftim të shkruar në njërën nga degët e Bankës për ndarjen nga jeta, apo paaftësinë e tij për të vepruar.;

17.2 Titullari/Bashkëtitullari i llogarisë duhet të njoftojë Bankën menjëherë në rast ndryshimi të adresës postare, të adresës së postës elektronike (e-mail), ose numrit të telefonit, ose të ndonjë të dhëne tjetër të përfshirë në këtë aplikim. Adresa e postës elektronike (e-maili) dhe numri I telefonit mund të ndryshohen prej klientit dhe në platformën Alpha E-banking.;

17.3 Këto kushte do të interpretohen në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe për qëllimin e zgjidhjes së çdo konflikti në lidhje me këtë,

17.4 Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga kjo kontratë do të jenë, në mënyrë të pakushtëzuar dhe të parevokueshme, subjekt i kompetencës tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

**18. Përgjegjësi të tjera të Bankës**

18.1 Banka nuk është përgjegjëse për humbjet që mund të rezultojnë gjatë periudhës, e cila fillon në momentin që Numri i Klientit, Fjalëkalimi dhe Pajisja Token nuk janë më në kontroll të Përdoruesit (ose përfaqësuesit të tij të autorizuar) dhe përfundon me një njoftim në Bankë, sipas masave të paragrafit 5.3 Seksioni 1, që Numri i Klientit, fjalëkalimi dhe Pajisja Token, kanë humbur, janë vjedhur, ose në ndonjë mënyrë ose tjetrën janë të ekspozuar për keqpërdorim. Njoftimi nga Përdoruesi drejtuar Bankës është i vlefshëm nga data e marrjes nga Banka dhe në rast se jepet gojarisht nuk është e vlefshme derisa të konfirmohet me shkrim brenda 7 ditëve.

18.2 Banka çlirohet nga çdo përgjegjësi kur humbja rezulton nga përdorimi i Numrit të Klientit, fjalëkalimi dhe Pajisjes Token nga një person i cili i ka siguruar ose kontrolluar me miratimin e përdoruesit ose kur Përdoruesi (ose përfaqësuesi i tij i autorizuar) kanë vepruar në mënyrë të pandershme, ose nga pakujdesia e madhe.

